

Herolind Limani, MA<sup>1</sup>

UDC: 321.7:004.773.6/.7  
316.658:004.773.6/.7

**STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E  
NJERIUT NË PËRDORIMIN E GJUHËVE**

**МЕЃУНАРОДНИ СТАНДАРДИ ЗА ЧОВЕКОВИ ПРАВА ВО  
УПОТРЕБАТА НА ЈАЗИЦИТЕ**

**INTERNATIONAL STANDARDS IN HUMAN RIGHTS IN THE  
USE OF LANGUAGES**

**Abstract**

This research paper is about the international human rights standards to language, which analyses and explains in detail the normative provisions of international instruments referring to the use of languages, starting from, (1) UN Declaration on the Rights of national or ethnic, cultural, religious and linguistic Minorities, as a more lenient instrument, followed by (2) The Framework Convention for the Protection of National Minorities, as a more general international instrument, which also contains provisions for the use of national minority languages and is binding on the parties, and to conclude the first chapter with (3) The European Charter for Regional or Minority Languages as a special international instrument for the use of languages of a binding nature to the parties.

The right to language in the international law is mainly related to minorities, as the states' official languages reflects on the use of the majority language (in administration, schools, court etc.). Thus, the use of majority language is not required to be guaranteed as a separate right,

---

<sup>1</sup> Inspektor për mbikëqyrjen e përdorimit të gjuhëve në Inspektoratin e Përdorimit të Gjuhëve

whereas human rights instruments guarantee the right to language of minorities, in the private and public sector.

International human rights instruments create a minimal standard for the use of minority languages, mainly in the private sector, as well as in education, media, administration etc. However, these are minimal standards, which allow states to go beyond what is required by the aforementioned instruments. In a word, international instruments can be considered as minimal standards, it should not prevent, for example, the use of the Albanian language as an official language in North Macedonia. wider than what the standards describe. And this is a known principle in the international law of human rights.

Above we have mentioned that, international instruments ensure the use of language, set a minimal standard, which later means that these instruments are usually very lenient and we are going to explain them from the most lenient one.

*Keywords: human rights, use of language, international standards, state*

## **1. DEKLARATA E OKB-së PËR TË DREJTAT E PERSONAVE QË U PËRKASIN PAKICAVE KOMBËTARE OSE ETNIKE, FETARE DHE GJUHËSORE**

Kjo deklaratë është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me rezolutën 47/135 në 18 Dhjetor 1992. Deri tek miratimi i kësaj deklarate kanë çuar shumë arsye por ne do të përmendim disa që mendojmë se janë më të rëndësishme e që janë të theksuara edhe në preambulën e deklaratës edhe atë: a) Duke pasur parasysh se nxitja dhe avancimi i mbrojtjes së të drejtave të personave që u takojnë pakicave etnike, fetare dhe gjuhësore i kontribuon stabilitetit politik dhe social të shtetit ku jetojnë ata; b) Duke theksuar se nxitja e vazhdueshme dhe realizimi i të gjitha të drejtave të personave që u takojnë pakicave etnike, fetare dhe gjuhësore, si pjesë integrale e zhvillimit të shoqërisë si tërësi dhe përbrenda një kornize demokratike të mbështetur në sundimin e ligjit, do t'i kontribuonte forcimit të miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet popujve dhe shteteve; c) si dhe të frymëzuar nga dispozitat e nenin 27 të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat

Civile dhe Politike<sup>2</sup> në lidhje me të drejtat e personave që u takojnë pakicave etnike, fetare dhe gjuhësore.

Mirëpo, kur jemi te neni 27 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike i formuluar në këtë mënyrë të ngushtë, mund të shohim se shtetet nuk ishin të gatshme t'i pranojnë të drejtat kolektive (grupore), nga frika e kërkesave për autonomi nga këto grupe dhe poashtu shtetet nuk dëshironin të merrnin detyrime eksplicite ndaj pakicave të tyre.<sup>3</sup> Andaj si rezultat i kësaj Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara vendosi të miratonte Deklaratën e të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare ose etnike, fetare dhe gjuhësore.

Kjo deklaratë përmban një sërë të drejtash që u përkasin pakicave të cilat janë të numëruara në neni 2 të saj dhe i njëjtin lexon si më poshtë:

1. Pjesëtarët e pakicave kombëtare apo etnike, fetare dhe gjuhësore (në tekstin e mëtejme: personat pjesëtarë të pakicave) kanë të drejtë ta gëzojnë apo të kënaqen me kulturën e tyre, të predikojnë e praktikojnë fenë e tyre dhe të përdorin gjuhën e tyre, qoftë privatisht apo në publik, në mënyrë të lirë dhe pa ndërhyrje apo çfarëdo forme të diskriminimit.

2. Pjesëtarët e pakicave kanë të drejtë të marrin pjesë aktivisht në jetën kulturore, fetare, sociale, ekonomike dhe publike.

3. Pjesëtarët e pakicave kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimet e marra në nivelin kombëtar, dhe aty ku është e përshtatshme, edhe në nivelin rajonal, në lidhje me pakicën të cilës i takojnë apo rajoneve në të cilat jetojnë, në mënyrë që nuk është në kundërshtim me ligjet e vendit.

4. Pjesëtarët të pakicave kanë të drejtë të themelojnë dhe mbajnë shoqata të tyre.

<sup>2</sup> Neni 27 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike lexon si vijon: Në shtetet ku ka pakica etnike, fetare ose gjuhësore, personat që u përkasin këtyre pakicave nuk mund të privohen nga e drejta që të kenë, së bashku me pjesëtarët e tjerë të grupit të vet, jetën e vet të veçantë kulturore, të predikojnë dhe të praktikojnë fenë e tyre ose të përdorin gjuhën e tyre.

Nga ky përkufizim i kësaj dispozite mund të shohim se edhe Pakti, ka përcaktuar vetëm atë që konsiderohet "standard minimal", sepse u kërkon shteteve që të respektojnë të drejtën e pakicave që të gëzojnë kulturën e vet, të predikojnë dhe të praktikojnë fenë e tyre ose të përdorin gjuhën e tyre. Dhe tani me të drejtë mund të themi se ky formulim i këtyre i përgjithshëm jep hapësirë për interpretime të ndryshme, sa i përket të drejtave të personave që u përkasin pakicave dhe në veçanti për të drejtën e përdorimit të gjuhës.

<sup>3</sup> Zejnullah Gruda, MBROJTJA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE TË NJERIUT, Prishtinë 2010, Botimi i pestë, f. 129.

5. Pjesëtarët e pakicave kanë të drejtë të vendosin dhe të mbajnë, pa kurrfarë diskriminimi, kontakte të lira dhe paqësore me pjesëtarët e grupit të tyre dhe me personat që u takojnë pakicave të tjera, si dhe kontakte përtej kufijve me qytetarët e shteteve të tjera me të cilët ata ndajnë lidhje kombëtare apo etnike, fetare apo gjuhësore.

Nga kjo që mund të shohim dhe veçojmë në nenin 2 të kësaj deklarate është se, Deklarata u garanton personave që i përkasin pakicave të drejtën që ta përdorin gjuhën e tyre si në sferën private ashtu edhe në atë publike (paragrafi 1).

Dhe tani kur jemi këtu po ashtu duhet thënë se, Deklarata i sugjeron shtetet të marrin masa “adekuate apo të përshtatshme” në mënyrë që “kudo që të jetë e mundur”, “personat që i përkasin pakicave të mund të kenë mundësi adekuate për të mësuar gjuhën e tyre amtare ose për të marrë mësim në gjuhën e tyre amtare”.<sup>4</sup>

Nëse marrim dhe analizojmë në tërësi Deklaratën e të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare ose etnike, fetare dhe gjuhësore do të mund të vërejmë se, Deklarata i përmban vetëm këto dy dispozita me të cilat u referohet dhe u garanton pjesëtarëve të pakicave të drejtën e përdorimit dhe të mësimit të gjuhës së tyre që i paraqitëm më lart. Mirëpo, nga kjo ne mund të konstatojmë se, vetëm me këto dy dispozita, deklarata nuk vërteton një standard të caktuar mbi përdorimin e gjuhëve. Pse e themi këtë?

Sepse nëse marrim dhe analizojmë me vëmendje nenin 2, paragrafin 1 të deklaratës, do të mund të shohim se, Deklarata nuk përcakton saktësisht se në çfarë mase mund të përdoret gjuha e pakicave, dhe nëse pjesëtarët e pakicave mund t'u drejtohen institucioneve në gjuhën e tyre, ose organet dhe institucionet publike mund ta përdorin gjuhën e pakicës si zyrtare. Por çka? E gjithë kjo mbetet e drejtë diskrecionale e shtetit.

Njëjtë ndodh edhe me formulimin e dispozitës tjetër ose më saktë, neni 4, paragrafi 3, që është shumë e butë dhe përsëri i jep shtetit diskrecion të gjerë. Kjo më së miri shihet nga fjala “kudo që të jetë e mundur”, e cila gjithmonë do të jetë çështje e diskrecionit të shtetit. Pra, kjo do të thotë se aty ku shteti mendon se është e mundur, por jo kudo, do t'ua lejojë pjesëtarëve të pakicave ta mësojnë gjuhën amtare.

Dhe po sipas kësaj deklarate, shtetet marrin përsipër se do të mbrojnë ekzistencën dhe identitetin kombëtar apo etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësore të pakicave brenda territoreve të tyre që do të thotë se ato

<sup>4</sup> Shih neni 4, paragrafi 3 i Deklaratës për të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare ose etnike, fetare dhe gjuhësore.

zotohen që të ruajnë jo vetëm ekzistencën fizike ndaj çdo tentative për spastrim fizik, por që edhe të inkurajojnë zgjidhjen e problemeve nëpërmjet dialogut të bazuar mbi parimet e së drejtës.<sup>5</sup> Nga ana tjetër këtu mund të shohim edhe një ekuilibrin në mes të drejtës së personave që u takojnë pakicave kombëtare ta ruajnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre, kulturën dhe gjuhën nga njëra anë, dhe nga ana tjetër nevojën për të siguruar se ata janë të aftë të integrohen më gjerë në shoqëri si anëtarë të njëjtë dhe të barabartë. Nga kjo perspektivë ky integrim nuk është i realizueshëm pa njohje të mirë të gjuhës ose gjuhëve zyrtare të shteti.<sup>6</sup>

Tjetër çka është e rëndësishme të thuhet kur jemi këtu para se të përfundojmë është fakti, se ky instrument përbën një deklaratë, dhe si e tillë kjo nuk është ligjërishit e detyrueshme për shtetet. Pra, ajo është pjesë e të ashtuquajturit ligj i butë.

Kjo është arsyeja pse ne konsiderojmë se këto janë standarde minimale, por këto nuk mund të shihen si pengesë nga shteti për të përshkruar përdorimin më të gjerë të gjuhëve minoritare ose rajonale brenda territoreve të tyre, sepse të drejtat e personave që u takojnë pakicave kombëtare për të përdorë gjuhën e tyre publikisht dhe privatisht, siç janë parashtruar dhe elaboruar në Rekomandimet e Oslos Lidhur me të Drejtat Gjuhësore të Pakicave Kombëtare duhet të shihen në një kontekst të gjerë shoqëror.<sup>7</sup>

## **2. KONVENTA KUADËR PËR MBROJTJEN E PAKICAVE KOMBËTARE**

Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare [këtu e tutje “Konventa Kuadër”] është një traktat ndërkombëtar i miratuar në Këshillin e Evropës më 01.02.1995 në Strasburg. Këtë konventë deri më sot e kanë ratifikuar 39 shtete, përfshirë edhe Maqedoninë e Veriut<sup>8</sup>.

Konventa Kuadër është instrumenti i parë shumëpalësh me karakter të detyrueshëm ligjor, ndryshe nga Deklarata e OKB-së për të

<sup>5</sup> Zejnullah Gruda, MBROJTJA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE TË NJËRIUT, Prishtinë 2010, Botimi i pestë, f. 131-132.

<sup>6</sup> Shih, Rekomandimet e Oslos lidhur me të Drejtat e Gjuhës të Pakicave Kombëtare & Sqarime, shkurt 1998. (më tutje në tekst: “Rekomandimet e Oslos”).

<sup>7</sup> Po aty, Rekomandimet e Oslo-s, shkurt 1998.

<sup>8</sup> Për numrin e ratifikimeve shih faqen zyrtare të Këshillit të Evropës, [https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/157/signatures?p\\_auth=vNvquAdG](https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/157/signatures?p_auth=vNvquAdG)

Ndërsa, Maqedonia e Veriut këtë konventë e ka ratifikuar në 1997.

drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare ose etnike, fetare dhe gjuhësore, kushtuar mbrojtjes së pakicave kombëtare në përgjithësi. Konventa Kuadër gjithashtu përcakton detyrime të buta ndaj palëve shtetërore. Ajo ka për qëllim të përcaktojë parimet ligjore ndaj të cilave shtetet angazhohen t'i respektojnë, për të siguruar mbrojtjen e pakicave kombëtare. Kjo më tutje nënkupton se, qëllimi kryesor i Konventës Kuadër është të sigurojë mbrojtje efektive të pakicave kombëtare dhe të të drejtave të personave që iu përkasin këtyre pakicave. Gjithashtu, ajo thekson se mbrojtja efektive duhet të sigurohet në kuadrin e shtetit ligjor, respektimit të integritetit territorial dhe sovranitetit kombëtar të shteteve.<sup>9</sup>

Kjo konventë angazhon shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, që, me qëllimin e ruajtjes dhe realizimit të mëtejshëm të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të mbrojnë ekzistencën e pakicave kombëtare në territoret e tyre përkatëse, duke vlerësuar se një shoqëri pluraliste dhe e vërtetë demokratike duhet që jo vetëm të respektojë identitetin etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të çdo personi që i përket një pakice kombëtare, por gjithashtu edhe të krijojë kushtet e nevojshme që u japin mundësi atyre për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar këtë identitet.<sup>10</sup>

Konventa Kuadër si e këtille, nuk i përkufizon pakicat kombëtare, për shkak se Komiteti i Ekspertëve nuk kishte mundur të gjente një përkufizim i cili do të mund të përfshinte të gjitha kategoritë e pakicave dhe që do të siguronte përkrahjen e të gjitha shteteve anëtare, as që nuk kishte rimarrë ndonjë përkufizim ekzistues.<sup>11</sup> Zbatimi i parimeve të parashtruara në këtë Konventë kuadër do të realizohej nëpërmjet legjislacionit kombëtar dhe politikave qeveritare të përshtatshme. Ajo nuk nënkupton njohjen e të drejtave kolektive. Theksi është vënë në mbrojtjen e personave që i përkasin pakicave kombëtare, që mund të ushtrojnë të drejtat e tyre në mënyrë individuale dhe në bashkësi me të tjerët (shih Nenin 3, paragrafi 2). Në këtë aspekt, Konventa kuadër ka të

<sup>9</sup> Shih, Raportin shpjegues të Konventës Kuadër, i përgatitur në format elektronik nga Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë (mars 2003), më konkretisht aty ku flitet për vlerësimet e përgjithshme (Objektivat e Konventës Kuadër – pika 10 dhe Sqarimi i parathënies së konventës - pika 28).

<sup>10</sup> Shih: nenin 5 të Konventës Kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare, 1995, (më tutje në tekst: “Konventa Kuadër”).

<sup>11</sup> Zejnullah Gruda, MBROJTJA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE TË NJERIUT, Prishtinë 2010, Botimi i pestë, f. 139-140.

njëjtën mënyrë trajtimi si ato të teksteve të miratuara nga organizatat e tjera ndërkombëtare.<sup>12</sup>

Konventa Kuadër ndahet në pesë pjesë: Dispozitat e pjesës së parë përcaktojnë se: çdo person që i përket një pakice kombëtare do të ketë të drejtën që të zgjedhë lirisht për t'u trajtuar apo jo si i tillë, dhe nuk do të ketë asnjë disavantazh nga kjo zgjedhje.<sup>13</sup> Dispozitat e pjesës së dytë dhe të tretë përcaktojnë: detyrimet e shteteve palë për t'u garantuar të drejtat dhe liritë themelore personave që u përkasin pakicave kombëtare, vis a vi, detyrimet e personave që i'u përkasin pakicave kombëtare për të respektuar legjislacionin kombëtar dhe të drejtat e të tjerëve, veçanërisht atyre të personave që i përkasin shumicës apo pakicave të tjera kombëtare. Ndërsa dispozitat e pjesës së katërt përcaktojnë, obligimet e shteteve që brenda një periudhe një vjeçare pas hyrjes në fuqi të Konventës, t'i dërgojnë informacion të plotë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për masat legislative dhe të tjera, të marra për zbatimin e parimeve të parashtruara në këtë Konventë kuadër. Dhe në pjesën e fundit kemi dispozitat përfundimtare të Konventës Kuadër që përfshin: hapjen për nënshkrim, hyrjen në fuqi, ratifikimin dhe miratimin etj.

Relevante për ne tek, Konventa Kuadër është hulumtimi, analizi mi dhe sqarimi i dispozitave të saj që u dedikohen pakicave kombëtare në lidhje me të drejtën e përdorimit të gjuhës. Kështu që ne do të fillojmë me rend shqyrtimin e dispozitave si vijojnë:

Duke filluar nga neni 9, paragrafi 1 i Konventës Kuadër, i cili lexon si vijon:

“Palët angazhohen të pranojnë se e drejta e lirisë së shprehjes së çdo personi që i përket një pakice kombëtare përfshin lirinë për të pasur mendime, dhe për të marrë dhe shpërndarë informacion e ide në gjuhën e pakicës, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pavarësisht nga kufijtë. Palët do të sigurojnë, brenda kuadrit të sistemeve të tyre ligjore, që personat që i përkasin një pakice kombëtare nuk diskriminohen lidhur me raportet e tyre me shtypin”.

Në këtë nen shihet qartë se, personat që u përkasin pakicave kombëtare janë të lirë “të kenë mendime të veta dhe të pranojnë dhe këmbëjnë informacione dhe mendime në gjuhën e pakicës, pa përzierje nga autoritetet publike dhe pa marrë parasysh kufizimet”. Më tej, i njëjti

<sup>12</sup> Shih, Raportin shpjegues të Konventës Kuadër, mars 2003, më konkretisht aty ku flitet për “mënyrat e trajtimit dhe konceptet themelore - pika 13”.

<sup>13</sup> Shih nenin 3, paragrafin 1, të Konventës Kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare, 1995.

koncept i obligon shtetet që “në kuadër të sistemit të tyre ligjor të sigurojnë që personat që u takojnë pakicave kombëtare mos të jenë të diskriminuar sa u përket medimeve”.<sup>14</sup> Mirëpo edhe pse fjalia e parë i referohet në mënyrë të veçantë lirisë për të marrë dhe shpërndarë informacion dhe ide në gjuhën e pakicës, ajo nënkupton gjithashtu lirinë për të marrë dhe shpërndarë informacion dhe ide në gjuhën e shumicës apo gjuhë të tjera.<sup>15</sup>

Duke e ditur tani se, mediat kanë një relevancë të madhe lidhur me të drejtat gjuhësore të pakicave kombëtare, pasi që ato luajnë rol esencial në promovimin dhe ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe identitetit, e drejta për të marrë dhe ndarë informacion dhe ide në një gjuhë pakice, siç parashikohet në Nenin 9 të Konventës Kuadër, varet nga mundësitë efektive për akses në media. Për më tepër, mundësia për të marrë dhe ndarë informacion në një gjuhë që kuptohet plotësisht nga dikush dhe në të cilën ai komunikon është parakusht për pjesëmarrje të barabartë dhe efektive në jetën publike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Për më tepër, në mënyrë që gjuha të zhvillohet në të gjitha fushat për t'i shërbyer folësit si mjet gjithëpërfshirës komunikimi, ajo duhet të jetë e pranishme në sferën publike, duke përfshirë dhe median publike.<sup>16</sup>

Në vazhdim do të japim sqarimet e duhura për Nenin 10, parag.1<sup>17</sup> të Konventës Kuadër i cili lexon:

1) Palët angazhohen të njohin që çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtën të përdorë lirisht dhe pa ndërhyrje gjuhën e tij/saj të pakicës, në mënyrë personale dhe publike, me gojë dhe me shkrim.

Në këtë nen tregohet se, shtetet do ta njohin të drejtën e personave që u takojnë pakicave kombëtare “ta përdorin lirisht dhe pa pengesa gjuhën e tyre, privatisht dhe publikisht, gojarisht dhe me shkrim”, sepse kjo është e një rëndësie të veçantë, pasi që, e drejta e përdorimit të gjuhës së pakicës në këtë mënyrë është një prej parimeve kyçe dhe

<sup>14</sup> Shih, Rekomandimet e Oslos, shkurt 1998, më konkretisht aty ku jepen sqarime rreth pjesës së Mediave.

<sup>15</sup> Shih, Raportin shpjegues të Konventës Kuadër, mars 2003, më konkretisht aty ku jepen shpjegime për “nenin 9, parag.1” - pika 56 e raportit.

<sup>16</sup> Shih, Komiteti Këshillimor i Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Komentari Tematik nr.3, ACFC/44DOC(2012)001rev, Strasburg, 5 korrik 2012. Më konkretisht, Pjesa IV (të drejtat gjuhësore dhe media), pika 40.

<sup>17</sup> Qasje të ngjashme si ky nen ka edhe Dokumenti i Mbledhjes së Kopenhagës të Konferencës për Dimensionin Njerëzor të KSBE-së, e mbajtur nga 5-29 Qershor 1990, më konkretisht pika (32.1) -... të përdorin lirshëm gjuhën e tyre amtare si në privat ashtu edhe në publik.



mjeteve kryesore nëpërmjet të cilës këta persona mund të pohojnë dhe ruajnë identitetin e tyre gjuhësor si dhe të ushtrojnë lirinë e shprehjes.

“Në publik” do të thotë, për shembull, në një vend publik, jashtë, apo në prani të personave të tjerë, por që nuk ka lidhje me ndonjë rrethënë në marrëdhëniet me autoritetet publike<sup>18</sup>, *për të cilën do të flasim në vazhdim kur do të sqarojmë paragrafin 2 të nenit 10.*

Edhe pse këto instrumente e tregojnë nevojën e përdorimit të gjuhëve të pakicave publikisht dhe privatisht, po të njëjtat nuk bëjnë ndarje precize të asaj se çka do të thotë “publike” përkundër sferave “private”. Këto sfera mund të përputhen. P.sh. kjo mund të ndodh kur individët vetë ose së bashku me të tjerët bëjnë kërkesë për të themeluar media ose shkolla të tyre private. Ajo që mund të fillojë si një iniciativë private mund të shndërrohet në çështje të interesit legjitim publik. Ky interes mund të shkaktojë ndonjë rregullativë publike. Përdorimi i gjuhëve të pakicave “publikisht dhe privatisht” nga personat që u takojnë pakicave kombëtare nuk mund të konsiderohet pa marrë parasysh edhe arsimin.<sup>19</sup> Sepse, të drejtat gjuhësore do të janë efektive vetëm nëse mund të gëzohen edhe në sferën publike.

Kur jemi këtu duhet potencuar edhe atë se Neni 10, paragrafi 1 i Konventës Kuadër e kufizon ndërhyrjen e shtetit në përdorimin publik të gjuhës së pakicës, deri në një masë të caktuar. Përdorimi “në publik” nënkupton atë që e kemi thënë pak më lart. Kjo dispozitë mëtutje mund të sqarohet edhe me atë se: shtetet angazhohen apo marrin përsipër që të mos ndërhyjnë apo pengojnë, pjesëtarët e komunitetit pakicë për ta përdorur gjuhën e tyre, në një vend publik, jashtë apo në prani të të tjerëve. E tani kjo është ajo masa e caktuar apo kufiri deri ku shtetet garantojnë se nuk do të ndërhyjnë. Nga këtu mund të vërejmë po ashtu, se shtetet i japin hapësirë të drejtës së përdorimit të gjuhës së pakicës, deri aty ku përdorimi i saj, nuk cenon interesin legjitim publik apo rendin publik. Pasi që në të kundërtën, shtetet mund të marrin masa me të cilën do të kufizojnë përdorimin e gjuhës së pakicës dhe pikërisht këtë do ta bëjnë atëherë kur aktivitete e institucioneve, organizatave apo ndërmarrjeve private do të cenojnë sigurinë publike apo sigurinë në vendin e punës. Ose me një fjalë tjetër rendin apo interesin legjitim publik, për të cilin shtete nuk janë të gatshme të lejojnë një gjë të tillë.

<sup>18</sup> Shih, Raportin shpjegues të Konventës Kuadër, mars 2003, më konkretisht aty ku jepen shpjegime për “nenin 10, paragrafi 1” - pika 63.

<sup>19</sup> Rekomandimet e Oslos, shkurt 1998. Shënime Shpjeguese për nenin 10, paragrafi 1.

Andaj duhet ta dimë që ekzistojnë instrumente ndërkombëtare që parashohin situata ku shtetet në mënyrë të arsyeshme do të kufizonin zbatimin e disa të drejtave të caktuara. Dhe këto kufizime nga e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut konsiderohen si të lejuara dhe mund të përdoren: në raste të kërcënimit të të drejtave dhe lirive të të tjerëve, në situata kur kërcënohet siguria kombëtare apo nacionale, shëndetësia publike, morali publik, mirëqenia e përgjithshme e një shoqërie demokratike etj.<sup>20</sup> Dhe këto kufizime që i përmendëm sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut duhet të interpretohen në mënyrë restriktive apo të ngushtuar.

Në vazhdim të temës, relevante për ta hulumtuar dhe sqaruar është edhe paragrafi 2 i nenit 10 i cili lexon si më poshtë:

2) Në zonat ku personat që i përkasin pakicave kombëtare banojnë tradicionalisht apo në numër thelbësor, në qoftë se këta persona parashetrojnë kërkesë, dhe kur ajo i përgjigjet një nevojë reale, Palët do të përpiqen të sigurojnë, për aq sa është e mundur, kushtet që mund të bëjnë të mundur përdorimin e gjuhës së pakicës në marrëdhëniet ndërmjet këtyre personave dhe autoriteteve administrative.

Siç shihet në këtë paragraf, janë paraparë kushtet të cilat duhet t'i përmbushin personat që i përkasin pakicave kombëtare me qëllim që të mundën ta përdorin gjuhën e tyre (të pakicës) në marrëdhëniet me autoritetet administrative. Apo siç thuhet në Komentarin e Tretë Tematik të Komitetit Këshillimor të Konventës Kuadër, se në këtë nen parashikohen kushtet sipas të cilave gjuhët e pakicave mund të përdoren dhe në lidhje me autoritetet administrative. Mirëpo, ky përdorim duhet bërë pa cenuar gjuhën/gjuhët zyrtare.

Pra, me një fjalë mund të themi se, sa i përket komunikimit ndërmjet personave që u përkasin pakicave dhe autoriteteve administrative, Konventa Kuadër kërkon përmbushjen e disa kushteve: a) zonat duhet të banohen nga personat që u përkasin pakicave kombëtare tradicionalisht ose në numër të konsiderueshëm (e cila është çështje interpretimi); b) personat duhet të kërkojnë dhe kërkesat duhet të korrespondojnë me një nevojë reale (e cila u jep shteteve një diskrecion të gjerë në vetvete); Ndërsa, formulimi "shtetet do të përpiqen të sigurojnë sa më shumë që

<sup>20</sup> Kufizimet e lartpërmendura janë të përfshira në dokumentet vijuese:

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 30;

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 19 (3);

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale, neni 10 (2).

të jetë e mundur" gjithashtu lë diskrecion të gjerë ndaj shtetit për të vendosur nëse ato mund të arrijnë të garantojnë një komunikim të tillë në gjuhën e pakicës midis pjesëtarëve të pakicave dhe autoriteteve administrative.<sup>21</sup> Pasi që kjo fjalë "për aq sa është e mundur" tregon faktorë të ndryshëm e në veçanti burimet financiare të Palës përkatëse, të cilat mund të merren në konsideratë, kur duhet të aplikohet gjuha e pakicës ndërmjet këtyre personave dhe autoriteteve administrative. E themi këtë, sepse ne e dimë që, krijimi i kushteve nga ana e shtetit përkatës për ta bërë të mundur përdorimin e gjuhë së pakicës në një vend apo zone të caktuar, kërkon para së gjithash, burime financiare, burime njerëzore si dhe krijimin e institucioneve përkatëse.

Tani, në momentin që do të plotësohen këto dy kriteret të parapara në Neni 10, parag.2 (vendbanimi tradicional ose numri domethënës dhe parashtrimi i kërkesës e cila duhet t'i përgjigjet një nevojë reale), palët do të përpiqen të sigurojnë përdorimin e gjuhës së pakicës në marrëdhëniet me autoritetet administrative, për aq sa është e mundur. Ndërsa, ekzistenca e një "nevojë reale" duhet të vlerësohet nga Shteti mbi bazën e kriterëve objektive.<sup>22</sup> Sepse "nevoja" në këtë kuadër nuk nënkupton paaftësinë e personave që u përkasin pakicave kombëtare të flasin gjuhën zyrtare dhe varësinë e tyre pasuese tek shërbimet në gjuhën e tyre të pakicës, mirëpo një kërcënim për funksionalitetin e gjuhës së pakicës si mjet komunikimi në një rajon të caktuar është i mjaftueshëm për të përbërë "nevojë" në kuptimin e Nenit 10.2 të Konventës Kuadër.<sup>23</sup>

Përderisa të drejtat e Nenit 10.2 preken nga një ndër dy kriteret kryesore (numri domethënës ose vendbanimi tradicional), ato zbatohen po ashtu dhe mbi zona të banuara vetëm nga një përqindje relativisht e vogël e pakicave kombëtare, me kusht që individët që i përkasin pakicave kombëtare të jenë banorë tradicionalë të zonave në fjalë, të ketë kërkesa nga këta individë dhe qëkëto kërkesa të korrespondojnë me një nevojë reale.<sup>24</sup>

Me këtë duam të tregojmë se, kufijtë numerikë nuk duhet të përbëjnë pengesë të panevojshme për përdorimin zyrtar të gjuhëve të

<sup>21</sup> Shih: nenin 10, parag. 2 të Konventës Kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare, 1995.

<sup>22</sup> Shih, Raportin shpjegues të Konventës Kuadër, mars 2003, më konkretisht aty ku jepen shpjegime për "nenin 10, paragrafi 2" - pika 65.

<sup>23</sup> Shih, Komiteti Këshillimor i Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Komentari Tematik nr.3, ACFC/44DOC(2012)001rev, Strasburg, 5 korrik 2012. Më konkretisht, Pjesa V (Përdorimi publik dhe privat i gjuhëve të pakicave), pika 56.

<sup>24</sup> Po aty.

caktuara të pakicave në zona të banuar nga individë që u përkasin pakicave kombëtare ose tradicionalisht, ose në shifra domethënëse. Në veçanti, kërkesa që grupi i pakicës të përfaqësojë të paktën gjysmën e popullsisë së një distrikti në mënyrë që të pranohet përdorimi i kontakteve të gjuhës së pakicës me autoritetet lokale administrative nuk është në përputhje me Konventën Kuadër. Kur ekzistojnë pragje, ato nuk duhet të zbatohen në mënyrë të prerë, por, në të kundërtën, ato duhet të ushtrohen me fleksibilitet dhe vëmendje të posaçme ndaj çështjeve gjuhësore të pakicave.<sup>25</sup>

Gjithashtu siç mund të shohim në këtë dispozitë (neni 10.2) nuk përfshihen të gjitha marrëdhëniet ndërmjet individëve që i përkasin pakicave kombëtare dhe autoriteteve publike. Por kjo shtrihet vetëm për autoritetet administrative. Megjithatë, këto të fundit, mund të interpretohen gjerësisht, për të përfshirë, për shembull, edhe ombudsmanin, siç thuhet edhe në Raportin Shpjegues të Konventës Kuadër.

Konventa Kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare, gjithashtu flet edhe për të drejtën e informimit në gjuhën e pakicës në proceset gjyqësore penale.

Sipas saj, “Palët angazhohen të garantojnë të drejtën e çdo personi që i përket një pakice kombëtare për t’u informuar menjëherë, në një gjuhë që ai/ajo e kupton, mbi arsyet e arrestimit të tij/saj, dhe për natyrën dhe shkakun e çdo akuze kundër tij/saj, dhe për të mbrojtur veten e tij/saj në këtë gjuhë, dhe nëse është e nevojshme me ndihmën pa pagesë të një përkthyesi”.<sup>26</sup>

Ose më thjeshtë thënë, kjo dispozitë konsiston në atë siç thuhet në Komentarin e Tretë Tematik të Komitetit Këshillimor që: “çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtë që gjatë proceseve penale të informohet për arsyet e arrestimit dhe për natyrën dhe shkakun e çdo akuze të ngritur kundër tij ose saj në një gjuhë që kuptohet prej tij/saj”.

Të drejtat e lartpërmendura, gjithashtu, garantojnë edhe në Nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.<sup>27</sup>

<sup>25</sup> Po aty.

<sup>26</sup> Shih, Nenin 10, parag.3 të Konventës Kornizë.

<sup>27</sup> Më konkretisht, këto të drejta i garanton neni 5, paragrafi 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore i cili thotë: “Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet”.

Dhe neni 6, paragrafi 3 nën a) Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë: “të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në

Me gjithë ekzistencën e dispozitave të këtilla, kjo e drejtë shpesh ndodh që të mos zbatohet në praktikë në mënyrë permanente dhe më shumë kjo ndodh te gjuhët e pakicave numerikisht më të vogla, ndërsa, deri te kjo sjellin dy shkaqe nëse mund të llogariten si të tilla: a) mungesa e burimeve financiare; b) mungesa e përkthyesve të kualifikuar.

Komiteti Këshillimor ka inkurajuar në mënyrë të vazhdueshme autoritetet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se të drejtat e gjuhëve të pakicave në sistemin gjyqësor të sigurohen plotësisht, duke përfshirë dhe fazat e hetimit dhe të paragjyqimit. Për më tepër, Komiteti Këshillimor ka mirëpritur garantimin e së drejtës për interpretim në një gjuhë pakice jo vetëm në kuadrin e proceseve penale, por edhe në kuadrin e proceseve civile dhe administrative.<sup>28</sup>

Tjetër dispozitë nga Konventa Kuadër, që ka rëndësi për t'u trajtuar nga ne është po ashtu edhe neni 11 me të tre paragrafët që në mënyrë të përgjithshme flet për të drejtën e: përdorimit në gjuhën e pakicës të emrit dhe mbiemrit të individit/ve që i përket ose përkasin pakicës; të drejtën e shfaqjes në gjuhën e tij/saj të pakicës shenja, mbi-shkrime dhe informacione të tjera të një natyre personale në mënyrë të dukshme për publikun si dhe nëse plotësohen kushtet e caktuara të drejtën e vendosjes së emrave tradicionalë lokalë, emrave të rrugëve dhe të treguesve të tjerë topografik të destinuara për publikun në gjuhën e pakicës. Do vazhdojmë t'i sqarojmë çdonjërin dispozitë me rend...

Neni 11, parag.1 lexon si vijon: “Palët angazhohen të njohin se çdo person që i përket pakicave kombëtare ka të drejtën të përdorë mbiemrin (prejardhjen) dhe emrat e parë në gjuhën e pakicës dhe të drejtën për njohjen e tyre zyrtarisht, në përputhje me procedurat e parashikuara në sistemin e tyre ligjor”.

Në këtë paragraf mund të shohim se bëhet fjalë për një të drejtë esenciale gjuhësore e cila është e lidhur ngushtë me identitetin dhe dinjitetin personal të individit. Më saktësisht me këtë nen parashihet se: personat që u takojnë pakicave kombëtare kanë të drejtë ta përdorin emrin e tyre personal, të babait të tyre dhe mbiemrin në gjuhën e vet.

---

mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij”; nën e) “të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq”.

<sup>28</sup> Shih, Komiteti Këshillimor i Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Komentari Tematik nr.3, ACFC/44DOC(2012)001rev, Strasburg, 5 korrik 2012. Më konkretisht, Pjesa V, (Përdorimi i gjuhëve të pakicave në marrëdhënie me autoritetet administrative në zonat e banuara tradicionalisht ose në numra të konsiderueshme nga pakicat kombëtare) - pika 59.

Dhe kjo e drejtë duhet të zbatohet në kuadër të rrethanave që janë tipike për çdo shtet.

Kur jemi këtu duhet potencuar se kjo dispozitë është formuluar në mënyrë të tillë që t'u japë mundësi Palëve (Shteteve) të zbatojnë atë në dritën e rrethanave të tyre të veçanta. Për shembull, Palët (Shtetet) mund të përdorin alfabetin e gjuhës së tyre zyrtare për të shkruar emrin(rat) e një personi që i përket një pakice kombëtare në formën e tij fonetike.<sup>29</sup> Mirëpo kjo nënkupton që duhet të bëhet në pajtim me sistemin gjuhësor dhe traditën e pakicës kombëtare në fjalë.<sup>30</sup>

Shtetet palë duhet të sigurohen se individët nuk kanë pengesa ose presione lidhur me përdorimin dhe njohjen e emrave të tyre në gjuhët përkatëse. Kjo nënkupton që nëpunësit përkatës civilë, si për shembull nëpunësit që japin certifikatat e lindjes, duhet të jenë të informuar për detyrimet që kanë.<sup>31</sup>

Në kuadër të kësaj të drejte esenciale e lidhur ngushtë me gjuhën dhe identitetin e individëve, personat të cilët kanë qenë të detyruar nga autoritetet publike të heqin dorë nga emrat e tyre origjinal ose të parardhësve të tyre si dhe të ndryshojnë ato kundër dëshirës së tyre, u jepet e drejta që t'i kthejnë emrat e tyre pa asnjë pagesë<sup>32</sup>, natyrisht në varësi të përjashtimeve në rastin e abuzimit të të drejtave apo ndryshimeve të emrit(rave) për qëllime kriminale<sup>33</sup>.

Po ashtu, Komiteti Këshillimor pret që e drejta e njohjes zyrtare të emrave në gjuhët e pakicave të respektohet gjithnjë plotësisht. Teknologjitë e reja e lehtësojnë përdorimin e shenjave diakritike dhe alfabetet e pakicave kombëtare. Për pasojë, shtetet inkurajohen të përdorin të gjitha mundësitë teknike të disponueshme për të ofruar garanci të plota dhe efektive për të drejtat e parashikuara në Nenin 11 të Konventës Kuadër.

Paragrafi 2, neni 11 parashikon se: “Palët angazhohen të njohin se çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtën të shfaqë në

<sup>29</sup> Shih, Raportin shpjegues të Konventës Kuadër, mars 2003, më konkretisht aty ku jepen shpjegime për “nenin 11, paragrafi 1” - pika 68.

<sup>30</sup> Rekomandimet e Oslos, shkurt 1998. Shënime Shpjeguese për nenin 11, paragrafi 1.

<sup>31</sup> Shih, Komiteti Këshillimor i Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Komentari Tematik nr.3, ACFC/44DOC(2012)001rev, Strasburg, 5 korrik2012. Më konkretisht, Pjesa V, (Manifestimet e gjuhëve të pakicave: Emrat e Përveçëm, Emrat e vendeve dhe Treguesit Topografikë), pika 61.

<sup>32</sup> Rekomandimet e Oslo-s, shkurt 1998.Shënime Shpjeguese për nenin 11, parag.1.

<sup>33</sup> Shih, Raportin shpjegues të Konventës Kuadër, mars 2003, më konkretisht aty ku jepen shpjegime për “nenin 11, paragrafi 1” - pika 68.

gjuhën e tij/saj të pakicës shenja, mbishkrime dhe informacione të tjera të një natyre personale (private) në mënyrë të dukshme për publikun”.

Tani, nga ky paragraf mund të shohim se buron e drejta që çdo individ që i përket një pakice kombëtare të mund të shfaq në gjuhën e tij/saj “shenja, mbishkrime dhe informacione të tjera të një natyre private, të dukshme për publikun”. Por kjo nuk e përjashton mundësinë që përveç gjuhës së tyre (pakicës) të përdorin edhe gjuhën zyrtare të shtetit apo gjuhët e pakicave të tjera nëse ka.

Ndërsa, dispozitat që e kufizojnë në mënyrë të padrejtë përdorimin e një gjuhe pakice (më vete ose si shtesë e gjuhës zyrtare) në reklama dhe njoftime, tabela dhe informacione të tjera të një natyre private, të dukshme për publikun, nuk janë në përputhje me Nenin 11.2 të Konventës Kuadër.

Shprehja “të një natyre personale (private)” e përdorur në këtë paragraf sipas Raportit Shpjegues dhe Komitetit Këshillimor të Konventës Kuadër u referohet të gjitha manifestimeve të një gjuhe pakice të cilat nuk janë zyrtare, duke përfshirë, për shembull, tabelat, posterët ose reklammat.

Paragrafi 3 i nenit 11 të Konventës Kuadër, synon të nxisë mundësinë për të shkruar në gjuhën e pakicës emrat tradicionalë lokal, emrat e rrugëve dhe tregues të tjerë topografikë, që janë për publikun, nëse zonat tradicionalisht janë të banuara nga një numër i konsiderueshëm i personave që i përkasin pakicave, nëse ekziston një kërkesë e mjaftueshme për këtë dhe u lejon shteteve palë të përpiqen ta bëjnë një gjë të tillë.<sup>34</sup> Nga kjo që thamë tani, mund të konkludojmë se kjo e drejtë e pakicave kombëtare (shkrimi në gjuhën e pakicës i emrave tradicionalë lokal, emrave të rrugëve dhe treguesve të tjerë topografikë, që janë për publikun), do të mund të realizohet vetëm nëse plotësohen kriteret e lartpërmendura. A kjo më tutje nënkupton se, realizimi i kësaj të drejte do të varet edhe nga vullneti i shtetit, sepse kjo dispozitë si edhe shumë të tjera në këtë Konventë janë formuluar në atë mënyrë që i japin shtetit një diskrecion të gjerë për të vendosur.

<sup>34</sup> Më konkretisht neni 11.3 lexon: “Në zonat e banuara tradicionalisht nga një numër thelbësor i personave të pakicave kombëtare, Palët do të përpiqen, në kuadrin e sistemit të tyre ligjor, përfshirë kur është e përshtatshme, marrëveshje me shtetet e tjera, dhe duke marrë parasysh kushtet e tyre të veçanta, të vendosin emrat tradicionalë vendas, emrat e rrugëve dhe tregues të tjerë topografikë për publikun edhe në gjuhën e pakicës, kur ka një kërkesë të mjaftueshme për këta tregues”.

Mirëpo, në anën tjetër, refuzimi për ta njohur validitetin e denominimeve historike të përshkruara më lart mund të përbëjë tentativë për t'u reviduar historia dhe të asimilohen pakicat, duke paraqitur kështu kërcënim serioz për identitetin e personave që u takojnë pakicave.<sup>35</sup>

Në zbatimin e këtij parimi apo paragrafi, Shtetet kanë të drejtë të marrin parasysh në shkallën e duhur rrethanat e veçanta dhe kuadrin e sistemeve të tyre ligjore, përfshirë kur është e përshtatshme edhe marrëveshjet me shtetet e tjera.<sup>36</sup> Natyrisht, shtetet nuk janë të obliguara të lidhin apo të bëhen pjesë e marrëveshjeve të këtilla me shtetet e tjera.

Neni 11.3 i Konventës Kuadër kërkon që shfaqja e shenjave në gjuhët e pakicës të ketë një bazë të qartë legjislative. Nuk është e mjaftueshme nëse kjo praktikë njihet si çështje fakti. Ajo duhet të jetë e mbështetur në ligj. Siguria e trafikut rrugor, ose përdorimi i alfabeve të ndryshëm nuk mund të përdoren si argumente kundër tabelave rrugore në dy gjuhë. Në të kundërtën, dygjuhësia në tabelat rrugore duhet të promovohet pasi tabelat japin mesazhe që në një territor të caktuar jetohet në harmoni ndërmjet grupeve të ndryshme të popullsisë.<sup>37</sup>

Kur jemi këtu, është me rëndësi ta përmendim, se si çështje tjetër të cilën Konventa Kuadër e trajton është edhe fusha e arsimit.

Kësaj fushe, Konventa ia dedikon neni 14, parag.1, 2, 3 i cili lexon:

1. Palët angazhohen të njohin se çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtën të mësojë gjuhën e tij/saj të pakicës;

2. Në zonat ku personat që i përkasin pakicave kombëtare banojnë tradicionalisht apo në numër thelbësor, nëse ka një kërkesë të mjaftueshme, Palët do të përpiqen të sigurojnë, për aq sa është e mundur, dhe në kuadrin e sistemeve të tyre arsimore, që personat që i përkasin këtyre pakicave të kenë mundësi të përshtatshme për të mësuar gjuhën e pakicës apo për të marrë mësim në këtë gjuhë;

3. Paragrafi 2 i këtij neni do të zbatohet pa cenuar mësimin e gjuhës zyrtare apo mësimin në këtë gjuhë.

<sup>35</sup> Rekomandimet e Oslos, shkurt 1998. Shënime Shpjeguese për nenin 11, paragrafi 3.

<sup>36</sup> Shih, Raportin shpjegues të Konventës Kuadër, mars 2003, më konkretisht aty ku jepen shpjegime për "nenin 11, paragrafi 3" - pika 70.

<sup>37</sup> Shih, Komiteti Këshillimor i Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Komentari Tematik nr.3, ACFC/44DOC(2012)001rev, Strasburg, 5 korrik 2012. Më konkretisht, Pjesa V, (Manifestimet e gjuhëve të pakicave: Emrat e Përveçëm, Emrat e vendeve dhe Treguesit Topografikë), pika 67.



Lidhur me të drejtën për arsim, siç mund të shohim Konventa Kuadër, i detyron Shtete që të njohin të drejtën e pjesëtarëve të pakicave për të mësuar gjuhën e tyre. Kjo e drejtë e proklamuar në këtë nen jo vetëm që është një mjet dhe mënyrë për ruajtjen dhe pohimin e identitetit si individual ashtu edhe kolektiv<sup>38</sup> por ajo formon dhe një bazë të rëndësishme për zhvillimin e repertorit gjuhësor individual dhe për njohjen e gjuhëve të tjera.<sup>39</sup>

Dispozita nga paragrafi 2, lidhet me mësimin dhe edukimin në një gjuhë pakice. Duke pasur parasysh vështirësitë e mundshme financiare, administrative dhe teknike, që shoqërojnë mësimin e apo në një gjuhë të pakicës, kjo dispozitë është formuluar në mënyrë mjaft fleksible, duke i lënë Palëve një masë të gjerë gjykimi.<sup>40</sup>

Apo me fjalë të tjera, në lidhje me mësimin në një gjuhë të tillë (të pakicës), Konventa Kuadër gjithashtu kërkon disa kushte të cilat janë të ngjashme si në nenin 10.2 për të cilat vlejné të njëjtat sqarime, si: së pari, fushat duhet të jenë të banuara tradicionalisht ose në numër të konsiderueshëm nga personat që i përkasin pakicave kombëtare; Së dyti, duhet të ketë një kërkesë të mjaftueshme për këtë; Së treti, palët shtetërore do të përpiqen të sigurojnë, sa të jetë e mundur, që pjesëtarët e pakicave të mësohen ose të marrin mësim në gjuhën e tyre. Me këtë formulim, Konventa Kuadër lë një diskrecion të madh për palët shtetërore për të vendosur nëse do të lejojnë brenda sistemeve të tyre arsimore, instruksionet në gjuhën amtare të pjesëtarëve të pakicave. Gjithashtu, Konventa Kuadër nuk specifikon në cilat nivele këto udhëzime do të jepen, qoftë në arsimin fillor, të mesëm apo të lartë. Kjo gjithashtu tregon qëllimin e hartuesve të Konventës për tu lejuar palëve shtetërore një diskrecion të gjerë mbi çështjet e përdorimit të gjuhëve të pakicave.<sup>41</sup>

Ndërsa paragrafi 3 i nenit 14, konsiston në atë që, në të njëjtën kohë personat që u takojné pakicave kombëtare duhet të mësojnë

<sup>38</sup> Rekomandimet e Hagës lidhur me të drejtat e shkollimit të pakicave kombëtare & Sqarime, tetor 1996 (më tutje në tekst: "Rekomandimet e Hagës"): gjithashtu proklamojné se: "E drejta e personave që u takojné pakicave kombëtare për të mbajtur identitetin e tyre mund të realizohet plotësisht në qoftë se u mundësohet arsimit në gjuhën amtare."

<sup>39</sup> Shih, Komiteti Këshillimor i Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Komentari Tematik nr.3, ACFC/44DOC(2012)001rev, Strasburg, 5 korrik 2012. Më konkretisht, Pjesa VI, (Të drejtat gjuhësore dhe Arsimi), pika 72.

<sup>40</sup> Shih, Raportin shpjegues të Konventës Kuadër, mars 2003, më konkretisht aty ku jepen shpjegime për "nenin 14, paragrafi 2" - pika 75.

<sup>41</sup> Shih: nenin 14, paragrafi 2 të Konventës Kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare, 1995

gjuhën zyrtare apo të shtetit. Pasi që si të mësuarit e gjuhës së pakicës ashtu edhe të mësuarit e gjuhës zyrtare të shtetit janë faktorë i rëndësishëm për sigurimin e aksesit apo pjesëmarrjes së barabartë në arsim por edhe në shoqëri në përgjithësi. Në këtë rast, njohja e gjuhës zyrtare është një faktor i kohezionit dhe integritit shoqëror. A e kundërta, mosnjohja e saj/tyre kufizon në mënyrë strikte mundësitë për personat që i përkasin pakicave kombëtare të marrin pjesë efektivisht në jetën publike dhe mund të pengojë futjen e tyre në arsimin universitar.<sup>42</sup>

Në shoqëritë shumëgjuhëshe, një sistem arsimor i baraspeshuar dhe gjithëpërfshirës duhet të kombinojë shkollimin në gjuhën shtetërore dhe në ato zyrtare me mundësi adekuate për nxënësit për ta mësuar gjuhën e tyre të pakicave ose për të ndjekur mësimin në këtë gjuhë. Arsimi në më shumë gjuhë ua shton vlerat nxënësve të të gjitha komuniteteve dhe shoqërisë në përgjithësi dhe duhet të inkurajohet për pakicat dhe shumicat njësoj.<sup>43</sup>

Si një konkluzion për Konventën Kuadër mund të themi se: Konventa Kuadër nuk përcakton nivelin e saktë të përdorimit të gjuhëve të pakicave, veçanërisht jo në publik. Konventa Kuadër nuk përcakton pikërisht kur anëtarët e pakicave mund të përdorin gjuhën e tyre në institucionet publike; a mund t'u drejtohen institucioneve publike në nivel qendror apo lokal në gjuhën e tyre; do të përgjigjet institucioni publik në gjuhën e pakicave; mund të mbahen procedurat gjyqësore dhe të tjera në gjuhën e pakicës; në çfarë niveli arsimor pakicat mund të përdorin gjuhën e tyre.<sup>44</sup>

Për në fund, për Konventën Kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare nga e gjithë kjo që kemi sqaruar më lartë mund të themi se, edhe pse është një instrument ligjërisht i detyrueshëm për palët, ajo përsëri është formuluar në atë mënyrë që u lejon shteteve një hapësirë apo diskrecion të gjerë për të vendosur se a do sigurojnë garantimin e

<sup>42</sup> Shih, Raportin shpjegues të Konventës Kuadër, mars 2003, Komiteti Këshillimor i Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Komentari Tematik nr.3, ACFC/44DOC(2012)001rev, Strasburg, 5 korrik 2012, Rekomandimet e Hagës, të cilat japin sqarime për paragrafin 3.

<sup>43</sup> Udhëzimet e Lubjanës për Integritin e Shoqërive Diverse & Shënime shpjeguese, Nëntor 2012, aty ku jepen sqarime për rëndësinë e Arsimit, f. 61.

<sup>44</sup> Bekim Kadriu & Ylber Sela, THE RIGHT TO USE THE ALBANIAN LANGUAGE AS AN OFFICIAL LANGUAGE IN MACEDONIA: THE NEW DRAFT LAW, ITS CONTENT, ADVANCEMENT AND COMPARISON, 6 th UBT Annual International Conference Durrës, Albania 27-29 October 2017, f. 3.

përdorimit të gjuhës së pakicave, veçanërisht në sferën publike, si dhe për çështje apo detyrime të tjera të cekura në Konventë dhe që i tangojnë shtetet palë. Pra në këtë mënyrë ajo përfaqëson një instrument ndërkombëtar shumë të butë.

Tjetër me rëndësi për Konventën që duhet të themi është se: Konventës në fjalë i janë bërë shumë vërejtje për shkak se: nuk i përkufigon pakicat; nuk ua njeh pakicave të drejtat kolektive; nuk e ndalon asimilimin vullnetar (neni 5 (2)); obligimet e shteteve i përcakton me shprehjet të cilat e relativizojnë karakterin detyrues të tyre si p.sh. “për aq sa është e mundur” (neni 10, 14), “kur është e nevojshme” (neni 12, 18), “në qoftë se e lejojnë burimet financiare” (neni 10, 13), “në qoftë se pakica ka një rëndësi të caktuar numerike” ose janë “në numër thelbësor”, “në qoftë se parashtrajnë kërkesë të mjaftueshme” dhe në qoftë se kjo “u përgjigjet nevojave reale”, ose vetë pakica ngarkohet në fushën financiare, për të garantuar efektivitetin e këtyre të drejtave (nenet 10, 11, 13, 14, 18)...<sup>45</sup>.

### **3. KARTA EVROPIANE E GJUHËVE RAJONALE (REGJIONALE/KRAHINORE) OSE TË MINORITETEVE**

Edhe Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve [në tekstin e mëtejme “Karta”], është një traktat ndërkombëtar i ngjashëm si Konventa Kuadër, e miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës.<sup>46</sup> Deri sot sipas statusit të Tetorit 2017, Kartën e kanë ratifikuar 25 shtete, ndërsa kur jemi këtu, Maqedonia e Veriut, Kartën vetëm e ka nënshkruar edhe atë në vitin 1996, por ende nuk e ka ratifikuar edhe pse kanë kaluar 21 vite nga nënshkrimi i saj.<sup>47</sup>

<sup>45</sup> Zejnullah Gruda, MBROJTJA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE TË NJERIUT, Prishtinë 2010, Botimi i pestë, f.141.

<sup>46</sup> Karta Evropiane e Gjuhëve Rajonale ose të Minoriteteve është miratuar në takimin e 478-të të Zëvendës Ministrave më 25 qershor 1992 dhe u hap për nënshkrim më 5 nëntor 1992 në Strasburg. Më hollësisht për Kartën shih: European Charter for Regional or Minority Languages, Strasbourg, 05/11/1992, ETS no. 148.

<sup>47</sup> Aktualisht, Karta është ratifikuar nga 25 shtete: Armenia, Austria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Qiproja, Republika Çeke, Danimarka, Finlanda, Gjermania, Hungaria, Lihtenshtajni, Luksemburgu, Mali i Zi, Holanda, Norvegjia, Polonia, Rumania, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra, Ukraina dhe Mbretëria e Bashkuar. Tetë shtete të tjera e kanë nënshkruar atë vetëm:

Azerbajxhani, Franca, Islanda, Italia, Malta, Moldavia, Federata Ruse dhe “ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë”. Ndërsa, Shqipëria dhe Gjeorgjia nuk janë ende palë të Kartës. (Qasur më 11.11.2017).

Pasi, edhe Karta përfaqëson një traktat ndërkombëtar, kjo nënkupton se ajo është e obligueshme vetëm për shtetet të cilat e kanë ratifikuar atë në parlamentet e tyre, por jo edhe për ato shtete të cilët vetëm e kanë nënshkruar, siç është Maqedonia e Veriut dhe shtete tjera.

Në këtë drejtim, Karta përbën instrumentin ndërkombëtar të radhës për të drejtat e njeriut, por jo më pak të rëndësishëm, për arsye se kjo ofron një nga standardet më të avancuara në lidhje me të drejtën e përdorimit të gjuhëve e cila është e dizajnuar për të mbrojtur dhe promovuar gjuhët rajonale dhe të pakicave.

Rëndësia e Kartës përveç tjerash qëndron edhe në atë se, na ndihmon ne, që të shmangim debatin nëse një grup i caktuar është pakicë ose jo. Kjo arrihet nëpërmjet përkufizimit që e jep Karta për gjuhët rajonale ose të pakicës dhe sipas saj, ajo zbatohet për gjuhët që janë të ndryshme nga gjuha(ët) zyrtare e(të) shtetit dhe që përdoren tradicionalisht në një territor të caktuar të një shteti nga shtetasit e atij shteti që formojnë një grup më të vogël se pjesa tjetër e popullsisë.<sup>48</sup> Thënë ndryshe, Karta mbulon gjuhët rajonale ose të pakicës, gjuhët jo-territoriale dhe gjuhët zyrtare më pak të përdorura. Mirëpo, ajo nuk mbulon gjuhët e folura nga pakicat etnike ose grupet e imigrantëve, si dhe nuk përcakton të drejta individuale ose kolektive për folësit e gjuhëve krahinore ose të pakicave. Dhe këtë e bënë pasi qëllimi i saj nuk është parashikimi i të drejtave të grupeve të pakicave etnike dhe/ose kulturore, por është të mbrojë dhe të nxisë gjuhët krahinore dhe të pakicave si të tilla në njërin anë dhe në anën tjetër të mundësojë folësit e një gjuhe rajonale ose të pakicës për ta përdorur atë në jetën private dhe publike. Dhe kjo thuhet qartë edhe në Preambulën e Kartës, se qëllimi kryesor i saj është aspekti kulturor, si një aspekt i kërcënuar i trashëgimisë kulturore të Evropës. Po ashtu duhet cekur se Karta nuk krijon një listë të gjuhëve evropiane që korrespondojnë me konceptin e gjuhëve rajonale ose të pakicave, por vetëm përcakton termat e përdorur sipas nenit 1 të saj.

Deri te miratimi i Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve kanë çuar disa faktorë të rëndësishëm:

a) rreziku që u kanosej gjuhëve regjionale ose të pakicave që të zhduken;

<sup>48</sup> Shih neni 1 të Kartës i cili përcakton gjuhën e rajonit ose të pakicës si një gjuhë që është (1) “përdorur në mënyrë tradicionale brenda një territori të caktuar të një shteti nga shtetasit e atij shteti, të cilët e formojnë një grup numerikisht më të vogël se pjesa tjetër e popullsisë së shtetit”; dhe (2) “që është e ndryshme nga gjuha (gjuhët) zyrtare të atij shteti”.

b) e drejta e patjetërsueshme e përdorimit të gjuhës rajonale ose të pakicës në jetën private dhe atë publike;

c) mbrojtja dhe nxitja e gjuhëve rajonale dhe të pakicës në vende dhe rajone të ndryshme të Evropës paraqet një kontribut të rëndësishëm për krijimin e një Evrope të bazuar në parimet e demokracisë dhe të llojllojshmërisë kulturore brenda kornizës së sovranitetit kombëtar dhe të integritetit territorial etj.<sup>49</sup>

Karta është e konstruktuar në pesë pjesë edhe atë: Preambula përmban (Arsyet e hartimit të Kartës dhe shpjegon qasjen e filozofisë bazë të saj); Pjesa I: përmban (Dispozitat e Përgjithshme); Pjesa II: përmban (Objektivat dhe Parimet) - të cilat janë të zbatueshme për të gjitha gjuhët krahinore dhe të pakicave; Pjesa III: përmban (Masat për përkrahjen e përdorimit të gjuhëve rajonale ose të pakicës në jetën publike) - veçanërisht në arsim, drejtësi, autoritete administrative, media, kulturë, aktivitete ekonomike dhe sociale. Kur jemi këtu është me rëndësi të potencojmë se: Shtetet palë të Kartës janë të detyruara të aplikojnë në minimalisht 35 paragrafë ose nënparagrafë të zgjedhur nga dispozitat e Pjesës III të Kartës, në lidhje me gjuhët e specifikuar nga pala në kohën e ratifikimit, pranimit ose miratimit.<sup>50</sup> Pjesa IV: përmban (Dispozita Zbatuese), ku përfshihet në veçanti krijimi i një komiteti evropian ekspertësh për të monitoruar zbatimin e Kartës. Dhe Pjesa V: përmban (Dispozitat Përfundimtare).

Marrë në përgjithësi, e gjithë Karta është e një rëndësie të veçantë për t'u trajtuar, por megjithatë, kur jemi tek përmbajtja e saj, e më konkretisht të Pjesa II, ku flitet për objektivat dhe parimet, e potencojë dhe njëherë, krejt janë me një peshë të veçantë, por unë kam zgjedhur që ta analizoj dhe shqyrtoj nenin 7, paragrafi 1.c dhe d i cili lexon si më poshtë:

Lidhur me gjuhët rajonale ose të pakicës, brenda territoreve në të cilat përdoren këto gjuhë dhe në pajtim me gjendjen e secilës gjuhë, palët i bazojnë politikën, legjisllacionin dhe praktikën e tyre në objektivat dhe parimet në vijim:

c. në nevojën për veprim të vendosur për përkrahjen e gjuhëve rajonale ose të pakicës në mënyrë që t'i ruaj ato;

d. në lehtësimin dhe /ose inkurajimin e përdorimit të gjuhëve rajonale ose të pakicës, në të folur dhe të shkruar, në jetën publike dhe atë private.

<sup>49</sup> Preambula e Kartës Evropiane për Gjuhët Regjionale ose të Pakicave.

<sup>50</sup> Shih te Karta Evropiane për Gjuhët Regjionale ose të Pakicave - neni 2, paragrafi 2.

Sa i përket, nevojës për veprim pozitiv në përkrahje të gjuhëve krahinore ose të pakicave si parim duhet thënë se, sot është e qartë se duke pasur parasysh dobësitë e shumë gjuhëve krahinore ose të pakicave, vetëm thjesht ndalimi i diskriminimit nuk është i mjaftueshëm për të siguruar mbijetesën e tyre. Ato kanë nevojë për mbështetje pozitive. Kjo është ideja e shprehur në paragrafin 1.c. Në këtë paragraf u lihet shteteve të përcaktojnë mënyrën në të cilën ata kanë ndërmend të veprojnë për të nxitur gjuhët krahinore dhe të pakicave në mënyrë që t'i mbrojnë këto gjuhë, por kreu thekson se këto masa duhet të jenë të vendosura.<sup>51</sup>

Ndërsa sa i përket paragrafi 1.d, përpjekja për nxitje duhet të përfshijë veprim në favor të mundësisë së përdorimit të gjuhëve krahinore ose të pakicave lirshëm si me gojë dhe me shkrim, jo vetëm në jetën private dhe në marrëdhëniet individuale, por dhe në jetën e komunitetit, pra brenda kuadrin të institucioneve, aktiviteteve sociale dhe jetës ekonomike. Vendi që mund të zërë një gjuhë krahinore ose pakice në kuadrin publike varet dukshëm nga tiparet e saj të veçanta dhe ndryshon nga një gjuhë në tjetrën. Karta nuk parashikon objektiva precize në këtë aspekt, por ajo bën thirrje për një përpjekje për nxitje.<sup>52</sup>

Edhe Karta ngjashëm si Konventa Kuadër, nuk paragjykon dispozitat më të favorshme në një shtet palë në lidhje me statusin e gjuhëve, që ekzistojnë qoftë në legjislacionin e brendshëm ose që rrjedhin nga traktate dypalëshe ose shumëpalëshe.<sup>53</sup> Thënë më thjeshtë kjo dispozitë nënkupton se: Kur gjuhë të caktuara ose pakica të caktuara që i përdorin këto gjuhë gëzojnë një status të përcaktuar në legjislacionin e brendshëm ose në marrëveshjet ndërkombëtare, qëllimi i Kartës nuk është të ulë të drejtat dhe garancitë e njohura nga këto dispozita. Mbrojtja që ofrohet nga Karta është shtesë e të drejtave dhe garancive që jepen nga instrumente të tjera. Për zbatimin e të gjitha këtyre angazhimeve ku ekzistojnë dispozita konkurruese për të njëjtin subjekt, mbi pakicat ose gjuhët e përfshira duhet të zbatohen dispozitat më të favorshme. Pra, prania e dispozitave më kufizuese në legjislacionin e brendshëm ose në angazhimet ndërkombëtare nuk duhet të jetë pengesë për zbatimin e

<sup>51</sup> Shih: Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve dhe Raportin Shpjegues, më konkretisht aty ku jepen sqarime për nenin 7, paragrafi 1.c (pika 61 e raportit).

<sup>52</sup> Shih: Po aty, ... sqarime për nenin 7, paragrafi 1.d (pika 62 e raportit)

<sup>53</sup> Shih: Nenin 4, parag.2 të Kartës.

Kartës.<sup>54</sup> Pra, Karta nuk i prek ose cenon të drejtat e fituara. Po ashtu duhet ta përmendim se, Karta bazohet në një qasje që plotësisht respekton sovranitetin kombëtar dhe integritetin territorial. Ajo nuk koncepton marrëdhënien midis gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve rajonale ose të pakicave në terma të konkurrencë ose antagonizmit.

Po ashtu, edhe te Karta do të veprojmë njëjtë ashtu si te instrumentet e lartpërmendura, pra do të japim shpjegimet e duhura në lidhje me dispozitat më të rëndësishme të Kartës, që u referohen gjuhëve rajonale ose të pakicave dhe sferave publike të përdorimit të këtyre gjuhëve.

Sa i përket përdorimit të gjuhëve rajonale ose të pakicave në arsim, Karta krijon një detyrim (të mundshëm) për palët për ta bërë të mundur: arsimin parashkollor, arsimin fillor, të mesëm, teknik-profesional si dhe atë universitar dhe të lartë në gjuhët rajonale ose të pakicave.<sup>55</sup>

Këtu do të japim shpjegime në lidhje me përdorimin e shprehjes “në numër të mjaftueshëm”<sup>56</sup> që përdoret në disa nënparagrafë.

Kjo shprehje nënkupton se, organeve publike nuk mund t’u kërkohet të marrin masat përkatëse kur situata e grupit gjuhësor e bën të vështirë sigurimin e numrit minimal të nxënësve që kërkohen për formimin e një klase. Në anën tjetër, duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të gjuhëve krahinore dhe të pakicave, sugjerohet që kuota normale që kërkohet për formimin e një klase të jetë fleksibël dhe që një numër më i vogël nxënësish të mund të konsiderohen “të mjaftueshëm”.<sup>57</sup>

Duke qenë se Karta u referohet edhe autoriteteve gjyqësore, dhe meqenëse e drejta për drejtësi ka kuptim vital për realizimin e të drejtave të njeriut, shkalla në të cilën mund të merret pjesë në mënyrë direkte dhe të lehtë në procedurat në dispozicion është masë e rëndësishme për këtë qasje. Prandaj dispozicioni i procedurave juridike që funksionojnë në gjuhën e personave që u takojnë pakicave kombëtare e bën këtë qasje më të lehtë dhe më direkte për këta persona.

Prandaj, neni 9 i Marrëveshjes Evropiane për Gjuhët Regjionale ose të Pakicave përcakton se, gjer te shkalla që i përgjigjet kërkesës të njëjës nga palët në fjalë, të gjitha procedurat juridike duhet të

<sup>54</sup> Shih: Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve dhe Raportin Shpjegues, më konkretisht aty ku jepen sqarime për nenin 4 ( - pika 53 e raportit).

<sup>55</sup> Karta Evropiane e Gjuhëve Regjionale ose të Pakicave, neni 8.

<sup>56</sup> Neni 8, paragrafi 1.a.iii; ...1.b.iv; ...1.c.iv; ...1.d.iii.

<sup>57</sup> Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve dhe Raportin Shpjegues, më konkretisht aty ku jepen sqarime për nenin 8 – Arsimi- ( - pika 82 e raportit).

zhvillohen në gjuhën regjionale ose të pakicës.<sup>58</sup> Apo me fjalë të tjera, Karta parashikon detyrim (të mundshëm) të shteteve-palë për të siguruar që gjykatat, me kërkesë të njëjës prej palëve, të zhvillojnë procedurat në çështjet penale, civile e administrative, në gjuhët rajonale ose të pakicës. Karta gjithashtu, i obligon palët: që t'ia garantojnë të akuzuarit të drejtën për përdorimin e gjuhës së tij rajonale ose të pakicës; dhe/ose; të sigurojnë që kërkesat dhe provat, pavarësisht a janë në formë të shkruar apo me gojë, nuk konsiderohen të papranueshme vetëm pse janë të formuluar në gjuhë rajonale ose të pakicës; dhe/ose; kur kërkohet, t'i paraqesin dokumentet që kanë të bëjnë me procedurat gjyqësore në gjuhën përkatëse rajonale ose të pakicës, nëse është e nevojshme duke i shfrytëzuar përkthyesit dhe përkthimet pa shkaktuar shpenzime shtesë për personat e përmendur.<sup>59</sup> Pra, të gjitha këto detyrime vlejnjë për të gjitha procedurat penale, civile dhe administrative.

Duhet të theksohet se paragrafi 1.a.ii, nëpërmjet të cilit palët zotohen t'i garantojnë të drejtën e përdorimit të gjuhës krahinore ose të pakicës të akuzuarit, shkon përtej të drejtës së të akuzuarit, të parashikuar në nenin 6, paragrafi 3.e, i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për pasjen e ndihmës falas të një përkthyesi nëse ai/ajo nuk e kupton gjuhën e përdorur gjatë gjykimit. Ashtu si nënparagrafi b.ii dhe c.ii, ky paragraf bazohet në konsideratat se edhe në rast se folësit e një gjuhe krahinore ose pakice janë në gjendje të flasin gjuhën zyrtare, kur bëhet fjalë për shprehjen para gjykatës, ata mund të ndiejnë nevojën e të shprehurit në gjuhën që është emocionalisht më pranë tyre, ose në gjuhën ku ndihen më rehat të flasin. Mirëpo, për shkak se kjo dispozitë shkon përtej aspektit strikt të të drejtave të njeriut, është konsideruar arsyeshme që shteteve t'u lejohej të vendosin të pranojnë ose jo këtë pikë dhe të kufizojnë zbatimin e saj në rrethe të caktuara gjyqësore.<sup>60</sup>

Palët në bazë të Kartës angazhohen që, të mos e mohojnë vlefshmërinë e dokumenteve juridike të hartuara në shtet vetëm për arsye se ato janë hartuar në gjuhën rajonale ose të pakicës. Këtu mund të shohim se bëhet fjalë, për vlefshmërinë e dokumenteve gjyqësore të hartuara në një gjuhë krahinore ose pakice. Në fakt objekti këtij është i kufizuar,

<sup>58</sup> Rekomandimet e Oslo-s, shkurt 1998. Shënime Shpjeguese për Organet Gjyqësore.

<sup>59</sup> Shih: Nenin 9, paragrafi 1.a(i,ii,iii,iv), b(i,ii,iii), c(i,ii,iii) dhe të Kartës Evropiane të Gjuhëve Rajonale ose të Pakicave.

<sup>60</sup> Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve dhe Raportin Shpjegues, më konkretisht aty ku jepen sqarime për nenin 9- Autoritete gjyqësore- ( - pika 95 e raportit).



pasi ai nuk jep të gjitha kushtet për vlefshmërinë e një dokumenti ligjor, por kufizohet vetëm në parashikimin se fakti që një dokument hartohet në një gjuhë krahinore ose pakice në vetvete dhe i vetëm nuk mund të jetë shkak për mohimin e vlefshmërisë së tij. Për më tepër, ai nuk e përjashton një shtet nga nxjerrja e formaliteteve të tjera shtesë në një rast të tillë, si për shembull nevojën për një formulë të veçantë certifikimi që i duhet bashkëngjitur dokumentit në gjuhën zyrtare.<sup>61</sup>

Për ta ezauruar edhe njëherë këtë që thamë më lart themi se, nëse merren parasysh standardet e lartpërmendura së bashku me qasjen adekuate të drejtësisë për shoqëri demokratike atëherë është e arsyeshme që nga shtetet të pritet sigurimi i së drejtës të personave që u takojnë pakicave kombëtare, të shprehen në gjuhën e tyre në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore “qoftë penale, civile ose administrative” dhe njëkohësisht të respektohen të drejtat e të tjerëve dhe të mbahet integriteti i proceseve, duke përfshirë këtu edhe procedurat e ankesave të dorëzuara.<sup>62</sup>

Sa i përket organeve administrative dhe shërbimeve publike, Karta kërkon për aq sa është e mundur nga: 1) autoritetet (organet) e administratës shtetërore, 2) autoritete lokale dhe rajonale administrative, si dhe 3) organet që ofrojnë shërbime publike, pa marrë parasysh sferën publike ose private, nëse ato mbeten nën kontrollin publik si (shërbimet postare, spitalet, energjia elektrike, transportin e kështu me radhë), që a) të përdorin gjuhët rajonale ose të pakicës; b) të sigurojnë që zyrtarët e tyre në kontakt me publikun t'i përdorin gjuhët rajonale ose të pakicës; c) të sigurojnë që përdoruesit/folësit e këtyre gjuhëve të dorëzojnë aplikimet/kërkesat me gojë ose me shkrim dhe të marrin përgjigje në këto gjuhë; ç) të sigurojnë që folësit e këtyre gjuhëve mund ta dorëzojnë në mënyrë të vlefshme një dokument në këto gjuhë; d) të vënë në dispozicion në gjuhë rajonale ose të pakicës ose në dy gjuhë tekstet dhe formularët administrativ që më së shumti përdoren; dh) t'i lejojnë autoritetet administrative të hartojnë dokumente në gjuhë rajonale ose të pakicës; e) të lejojnë ose inkurajojnë publikimin e dokumenteve zyrtare nga ana e autoriteteve rajonale dhe lokale në gjuhët përkatëse rajonale ose të pakicës; ë) përdorimin nga ana e autoriteteve rajonale dhe lokale të gjuhëve rajonale ose të pakicës në debatet në kuvendet e tyre, pa e përjashtuar, megjithatë, përdorimin e gjuhës (të gjuhëve) zyrtare të shtetit; f) përdorimin ose miratimin, nëse është e

<sup>61</sup> Shih: Neni 9, paragrafi 2.a të Kartës dhe Raportin Shpjegues, po aty (pika 97 e raportit).

<sup>62</sup> Rekomandimet e Oslos, shkurt 1998. Shënime Shpjeguese për Organet Gjyqësore.

domosdoshme në lidhje me emrin në gjuhën (gjuhët) zyrtare, të formave tradicionale dhe të rregullta të emrave të vendeve në gjuhët rajonale ose të pakicës; g) ta lejojnë përdorimin ose miratimin e mbiemrave në gjuhët rajonale ose të pakicës, me kërkesë të atyre personave etj.<sup>63</sup>

Pasi që gjuha përveç tjerash është edhe mjet për komunikim publik, atëherë edhe përdorimi i saj nuk mund të reduktohet vetëm në sferën e marrëdhënieve private, prandaj Karta me të drejtë i kushton një rëndësi të posaçme, përdorimit të gjuhës/ve krahinore ose të pakicës/ave nga ana e autoriteteve administrative dhe shërbimeve publike. Prandaj, qëllimi i dispozitave të lartpërmendura të Kartës është, dhënia e mundësisë që përdoruesit e gjuhëve rajonale ose të pakicave të mund të realizojnë të drejtat e tyre si qytetarë dhe përmirësimi i komunikimit në mes organeve publike dhe personave që përdorin këto gjuhë. Në parim është e vërtetë që, personave që u lejohet përdorimi i gjuhës së pakicës, e njohin edhe gjuhën zyrtare të shtetit apo ndryshe thënë janë bilingual dhe janë në gjendje ta përdorin edhe gjuhën zyrtare të shtetit për të komunikuar me autoritetet publike, por esenca dhe madhështia e lejimit të përdorimit të gjuhëve krahinore ose të pakicave në raport me organet publike administrative është shumë i rëndësishëm për zhvillimin dhe statusin e këtyre gjuhëve dhe këtë mund ta vërtetojmë me faktin se nëse ju e pengoni tërësisht një gjuhë nga ndërveprimi i saj me organet publike, kjo domethënë se ju e mohoni këtë gjuhë si të këtillë. Për më tepër, nëse një gjuhë nuk i jepet akses në sferën politike, ligjore ose administrative, ajo do të humbë gradualisht të gjithë potencialin e saj terminologjik dhe do të bëhet një gjuhë “e cunguar”, e paaftë për të shprehur çdo aspekt të jetës së komunitetit.<sup>64</sup>

E rëndësishme për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhëve rajonale ose të pakicave është edhe koha dhe hapësira që mund t’u sigurohet atyre në media. Është e pakuptimit që sot gjuhët e këtilla, por jo vetëm, të ruajnë ndikimin e tyre pa pasur hapësirë dhe akses në format e reja të komunikimeve masive. Prandaj, Karta si instrument ndërkombëtar i kushton qasje edhe medias.

Tani, sa i përket medias, Karta kërkon nga Shtetet palë të saj: (a) të sigurojnë së paku hapjen e një radio stacioni dhe të një kanali televiziv në gjuhët rajonale ose të pakicës; (b) të marrin masa të

<sup>63</sup> Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve, neni 10.

<sup>64</sup> Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve dhe Raportin Shpjegues, më konkretisht aty ku jepen sqarime për nenin 10- Autoritete administrative dhe Shërbimet publike- ( - pika 101 e raportit).

përshtatshme në mënyrë që transmetuesit të ofrojnë programe në gjuhët rajonale ose të pakicës; (c) të inkurajojnë dhe/ose ta ndihmojnë transmetimin rregullt të programeve të radios në gjuhët rajonale ose të pakicës; (ç) të inkurajojnë dhe/ose ta ndihmojnë transmetimin e rregullt të programeve televizive në gjuhët rajonale ose të pakicës; (d) të inkurajojnë dhe/ose ta ndihmojnë incizimin dhe shpërndarjen e punës audiovizuale në gjuhët rajonale ose të pakicës; (dh) të inkurajojnë dhe/ose ta ndihmojnë krijimin dhe/ose mbajtjen e së paku një gazete në gjuhët rajonale ose të pakicës; (e) të përkrahin aftësimin e gazetarëve dhe të personelit tjetër të mjeteve të komunikimit që i përdorin gjuhët rajonale dhe të pakicës etj.<sup>65</sup>Karta gjithashtu kërkon që palët shtetërore "të garantojnë lirinë e marrjes së drejtpërdrejtë të transmetimeve radiotevizive nga vendet fqinje në një gjuhë të përdorur në formë identike ose të ngjashme me një gjuhë rajonale ose të pakicës, dhe të mos kundërshtojnë ritransmetimin e transmetimeve radiotevizive nga vendet fqinje në një gjuhë të tillë.<sup>66</sup>

Karta Evropiane e Gjuhëve Krahinore ose të Pakicave kërkon që palët të garantojnë se interesat e përdoruesve të gjuhës minoritare janë përfaqësuar ose janë marrë parasysh, sidomos përbrenda organeve rregullative të mediave elektronike.<sup>67</sup> Këtë e themi pasi e dimë që, media përbën një fushë ku ndërhyrja publike është e kufizuar dhe masat nëpërmjet rregulloreve nuk janë shumë efektive.

Sa i përket aktiviteteve dhe objekteve kulturore sidomos (bibliotekat, video bibliotekat, qendrat kulturore, muzetë, arkivat, akademitë, teatrot dhe kinematë, si edhe veprat letrare dhe produksionet filmike, format amtare të shprehjes kulturore, festivalet dhe industritë kulturore, përfshirë edhe teknologjitë më të reja), Karta i obligon shtetet palë (a) të inkurajojnë llojet e shprehjes dhe të nismave që janë specifike për gjuhët rajonale ose të pakicës dhe të nxisin mjetet e ndryshme të qasjes në veprat e punuara në këto gjuhë;(b) të nxisin mjetet e ndryshme të qasjes së gjuhëve të tjera në veprat e punuara në gjuhët rajonale ose të pakicës duke e ndihmuar dhe zhvilluar përkthimin, dublimin, pas-sinkronizimin dhe aktivitetet e titimit;(c) të nxisin qasjen e gjuhëve rajonale ose të pakicës në veprat e punuara në gjuhët e tjera duke e ndihmuar dhe zhvilluar përkthimin, dublimin, pas-sinkronizimin dhe aktivitetet e

<sup>65</sup> Për më tepër shih: Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave, neni 11, paragrafë 1.

<sup>66</sup> Po aty, neni 11, paragrafë 2.

<sup>67</sup> Po aty, neni 11, paragrafë 3.

titrimin; (ç) të sigurojnë që organet përgjegjëse për organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve kulturore të llojeve të ndryshme japin ndihmë të duhur financiare për përfshirjen e njohurisë dhe të përdorimit të gjuhëve dhe kulturës së pakicave në aktivitetet të cilat i fillojnë ose për të cilat ofrojnë mbështetje; (d) t'i përkrahin masat për të siguruar që organet të cilat janë përgjegjëse për organizimin ose mbështetjen e aktiviteteve kulturore kanë në disponim personel që kanë njohuri të plotë të asaj gjuhe rajonale ose të pakicës, si edhe të gjuhës (-ve) të pjesës tjetër të popullsisë; (dh) ta inkurajojnë pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të përfaqësuesve të folësve të gjuhës së caktuar rajonale ose të pakicës duke i siguruar objektet dhe duke planifikuar aktivitete kulturore; (e) ta inkurajojnë dhe/ose ta ndihmojnë krijimin e një organi ose të disa organeve përgjegjëse për mbledhjen, mbajtjen e një kopjeje të veprave ose prezantimin dhe botimin e veprave të punuara në gjuhët rajonale ose të pakicës; (ë) nëse është e nevojshme, t'i krijojnë dhe/ose t'i përkrahin dhe financojnë shërbimet e përkthimit dhe të kërkimit të terminologjisë, sidomos me qëllim të ruajtjes dhe të zhvillimit të terminologjisë së duhur administrative, komerciale, ekonomike, sociale, teknike ose juridike në secilën gjuhë rajonale ose të pakicës.<sup>68</sup> Karta po ashtu i obligon shtetet, që të lejojnë, të inkurajojnë dhe/ose të ofrojnë aktivitete dhe objekte të përshtatshme kulturore në pajtim me paragrafin paraprak, në territoret e tjera në të cilat përdoren gjuhët rajonale ose të pakicës në mënyrë tradicionale dhe nëse numri i folësve të gjuhës rajonale apo të pakicës e justifikon këtë. Tani, pasi që të gjitha shtetet kërkojnë të promovojnë kulturën e tyre kombëtare jashtë shteti, Karta ka paraparë dispozitë me të cilën i angazhon palët, që të marrin masat e duhura, gjatë ndjekjes së politikës së tyre kulturore jashtë vendit, për gjuhët rajonale ose të pakicës dhe të kulturës që e pasqyrojnë ato.<sup>69</sup>

Dhe po ashtu nen të veçantë Karta i kushton edhe jetës ekonomike dhe sociale, por duke e ditur këtu se në sistemet ekonomike dhe sociale ndërhyrja e organeve publike zakonisht kufizohet me anë të ligjeve dhe rregulloreve, që kjo më tutje nënkupton se organet publike janë të kufizuara që të ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar që gjuhët rajonale ose të pakicave të mbulohen siç duhet në këtë fushë, Karta ka parashikuar disa masa në këtë sektor, ku në njërin anë ajo kërkon të eliminojë masat për ndalimin ose dekurajimin e përdorimit të gjuhëve

<sup>68</sup> Po aty, neni 12, paragrafë 1.

<sup>69</sup> Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave, neni 12, paragrafë 2 dhe 3.

të tilla në jetën ekonomike dhe sociale dhe në anën tjetër, propozon disa hapa pozitive.

Më saktë Karta kërkon nga palët ndërshtetërore që në tërë vendin ato: (a) ta mënjanojnë nga legjislacioni i tyre çdo dispozitë me të cilën ndalohet ose kufizohet pa arsye përdorimi i gjuhëve rajonale ose të pakicës në dokumentet që kanë të bëjnë me jetën ekonomike ose shoqërore, sidomos në (kontratat e punësimit), dhe në dokumentet teknike siç janë udhëzimet për përdorimin e prodhimeve ose të pajisjeve; (b) të ndalojnë dispozitat dhe klauzolat në dokumentet e brendshme të kompanive që përjashtojnë ose kufizojnë përdorimin e gjuhëve rajonale ose të pakicave, së paku ndërmjet përdoruesve të të njëjtës gjuhë; (c) të kundërshtojnë praktikat që dekurajojnë përdorimin e gjuhëve rajonale ose të pakicave. Ndërsa sa i përket aktiviteteve ekonomike dhe shoqërore, Karta kërkon nga shtetet palë, (a) që të përfshijnë në rregulloret financiare dhe bankare dispozitat që do të lejojnë përdorimin e gjuhëve rajonale ose të pakicave në urdhërpagesat (çeqet, draftet etj.) Ose dokumente të tjera financiare; (b) në sektorët ekonomik dhe shoqëror të cilat janë drejtpërdrejt në kontrollin e tyre (sektori publik), të organizojnë aktivitete për përkrahjen e përdorimit të gjuhëve rajonale ose të pakicës; (c) të përkujdesen që objektet për përkujdesje shoqërore siç janë spitalet, shtëpitë e pleqve dhe azilet ofrojnë mundësi të pranimit dhe të trajtimit në gjuhën e tyre personat që e përdorin gjuhën rajonale ose të pakicës dhe të cilët kanë nevojë për shkak të shëndetit të ligë, moshës së vjetër ose për arsye të tjera; (ç) të sigurojnë përmes mjeteve të përshtatshme që udhëzimet për sigurinë të hartohen poashtu edhe në gjuhët rajonale ose të pakicës; (d) të përkujdesen që informatat e ofruara nga autoritetet publike kompetente lidhur me të drejtat e konsumatorëve të jenë në dispozicion në gjuhët rajonale dhe të pakicës.<sup>70</sup>

Karta nuk ka lënë pa cekur as edhe shkëmbimet ndërkufitare, për të cilat i angazhon palët që: (a) t'i zbatojnë marrëveshjet ekzistuese dypalëshe dhe shumëpalëshe të cilat i lidhin ato me shtetet në të cilat përdoret gjuha e njëjtë në formë të njëjtë apo të ngjashme, ose nëse është e nevojshme të kërkojnë të arrijnë marrëveshje të tilla, në atë mënyrë që t'i nxisin kontaktet ndërmjet folësve të gjuhës së njëjtë në shtetet në fjalë në fushën e kulturës, të arsimit, informimit, aftësimin profesional dhe arsimit të përhershëm; (b) për interes të gjuhëve rajonale ose të pakicës, ta ndihmojnë dhe/ose ta përkrahin bashkëpunimin përtej

<sup>70</sup> Po aty, neni 13, paragrafi 1 dhe 2.

kufirit, në veçanti ndërmjet autoriteteve rajonale dhe lokale në territorin e të cilave përdoret gjuha e njëjtë në formë të njëjtë ose të ngjashme.<sup>71</sup> Bashkëpunimi i parashikuar mund të shtrihet për çështje të tilla si binjakëzimet e shkollave, shkëmbimet e mësuesve, njohja e ndërsjellë të diplomave dhe kualifikimeve, organizimi i përbashkët i aktiviteteve kulturore, qarkullimi i mëtejshëm i aseteve kulturore (librave, filmave, ekspozitave, etj.) dhe aktiviteteve ndërkufitare të agjencive kulturore (kompanitë teatrale, lektorët, etj.).<sup>72</sup>

Krejt për në fund mund të konkludojmë se, prej të gjithë instrumenteve që i kemi përmendur më lart, Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve përbën njërin nga instrumentet ndërkombëtare më të përparuar dhe më të avancuar sa i përket përdorimit të gjuhëve. E themi kështu, pasi që Karta krijon gjendje apo status shumë të avancuar për gjuhët regjionale ose të pakicave dhe njëkohësisht krijon rregulla të qarta se në cilat fusha dhe në cilat kushte përdoruesit e gjuhëve rajonale dhe të pakicave mund të përdorin ato gjuhë, veçanërisht në jetën publike, gjë të cilën nuk e bënin as Deklarata e OKB-së për të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare ose etnike dhe fetare ose gjuhësore, as Konventa Kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare.

Si instrument ndërkombëtar, Karta është shumë relevante edhe për Maqedoninë e Veriut, megjithëse Maqedonia e Veriut ende nuk e ka ratifikuar, madje 22 vjet pas nënshkrimit të saj. Karta është një instrument për t'u përmendur, kur flasim për statusin e gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut, pasi që Karta gjithashtu krijon një status të caktuar të gjuhëve rajonale ose të pakicave që është shumë afër asaj se çfarë statusi ka gjuha shqipe në Maqedoninë e Veriut. Pra, ekziston një argument i madh se në të drejtën ndërkombëtare ekziston një standard mbi përdorimin e gjuhëve që mbështesin statusin e gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut.<sup>73</sup>

<sup>71</sup> Po aty, neni 14.

<sup>72</sup> Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve dhe Raportin Shpjegues, më konkretisht aty ku jepen sqarime për nenin 14 – Shkëmbimet ndërkufitare- ( - pika 126 e raportit).

<sup>73</sup> Bekim Kadriu & Ylber Sela, THE RIGHT TO USE THE ALBANIAN LANGUAGE AS AN OFFICIAL LANGUAGE IN MACEDONIA: THE NEW DRAFT LAW, ITS CONTENT, ADVANCEMENT AND COMPARISON, 6 th UBT Annual International Conference Durrës, Albania 27-29 October 2017, f. 4.

## Conclusion

The right to one's mother tongue is a fundamental human right, which as such is also guaranteed by international human rights instruments. These instruments guarantee individuals, mainly persons belonging to minorities, the right to use their language in both the private and public spheres. However, such international instruments create minimum international standards for the use of minority languages, and since these are minimum standards, nothing prevents states from going beyond what is provided by these instruments. Therefore, the use of the Albanian language in the Republic of North Macedonia, in addition to being in accordance with these instruments, goes beyond these international instruments and there should not be anything wrong with it, because these instruments can not be seen as a applicable standard for the use of the Albanian language in Macedonia, they should be seen as a minimum standard, but not as an obstacle for the Albanian language to be used as an official language like the Macedonian language in the Republic of North Macedonia, beyond what are set by such international standards. Among the international instruments, about the Declaration on the Rights of national or ethnic, cultural, religious and linguistic Minorities can be said to be a general instrument and by its very definition, it is merely a declaration and as such is not legally binding on the parties or states, but in a word they are part of the so-called "soft law". Regarding The Framework Convention for the Protection of National Minorities, unlike the Declaration, this is the first multilateral instrument with a legally binding character, whose main goal is the effective protection of ethnic minorities and the rights of persons belonging to these minorities. Effective protection of national minorities under the Convention must be ensured within the framework of the rule of law, respect for the territorial integrity and national sovereignty of states. As seen in the Framework Convention, the emphasis is on the protection of persons belonging to national minorities, so that they can exercise their rights individually and in community with others, but this does not mean the recognition of collective rights, meaning, the Convention does not recognize the collective rights of minorities. The Framework Convention is also a general international instrument regarding the use of languages by ethnic minorities and as such it also imposes soft obligations on state parties as it is formulated in a way that gives states a wide space or discretion to decide whether to ensure the use of

minority languages, especially in the public sphere, as well as on other issues or obligations set out in the Convention and that affect States Parties. While, the next instrument for human rights in this regard is the European Charter for Regional or Minority Languages, which represents an international treaty and as such is binding on all states that have ratified it, but not on those which have only signed, one of which is the Republic of North Macedonia. The Charter represents a special instrument in terms of the use of languages and as such is of particular importance because it provides one of the most advanced standards regarding the right to use languages, which is designed to protect and promote regional, and minority languages. The Charter also establishes clear rules about the fields and under what conditions users of regional and minority languages may use those languages, especially in public life, which neither the Declaration nor the Framework Convention did. In addition, it is important that it helps us to avoid the debate over whether a particular group is a minority or not, and it does so precisely through the definition it gives for regional or minority languages. According to it, it applies to languages that are different from the official language(s) of the state and traditionally used in a given territory of a state, by the nationals of that state that make up a smaller group than the rest of the population. The main purpose of the Charter is to protect and promote regional and minority languages as being such on one hand, and to enable speakers of a regional or minority language to use it in private and public life; not to predict the rights of ethnic and / or cultural minority groups, which means that the Charter does not define individual or collective rights for speakers of regional or minority languages. The Charter as an international instrument is very relevant for the Republic of North Macedonia, although 22 years after the signing it has not yet been ratified, because it creates a certain status of regional or minority languages that is very close to what status the Albanian language has in North Macedonia. In a word, in the international law there is a standard on the use of languages that supports the status of the Albanian language in North Macedonia.

**Recensentë:**

**Doc. dr. Kujtim Kasami**

**Prof. Dr. Bujar Ahmedi**



**Literatura:**

- Gruda, Z., 2010. *Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut*. Botimi i pestë. Prishtinë;
- Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike;
- Deklarata e OKB-së për të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare ose etnike, fetare dhe gjuhësore;
- Rekomandimet e Oslos lidhur me të Drejtat e Gjuhës së Pakicave Kombëtare & Sqarime, shkurt 1998;
- [https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/conventions/treaty/157/signatures?p\\_auth=vNvquAdG-](https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/conventions/treaty/157/signatures?p_auth=vNvquAdG) Numri i ratifikimeve të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, 1995;
- Raporti shpjegues i Konventës Kuadër, i përgatitur në format elektronik nga Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë (mars 2003);
- Komiteti Këshillimor i Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Të Drejtat Gjuhësore të personave që u përkasin Pakicave Kombëtare sipas Konventës Kuadër, Komentari Tematik nr.3, ACFC/44DOC(2012)001rev, Strasburg, 5 korrik 2012;
- Dokumenti i Mbledhjes së Kopenhagenit të Konferencës për Dimensionin Njerëzor të KSBE-së, e mbajtur nga 5-29 Qershor 1990;
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale;
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore;
- Rekomandimet e Hagës lidhur me të drejtat e shkollimit të pakicave kombëtare & Sqarime, tetor 1996;
- Bekim Kadriu & Ylber Sela, THE RIGHT TO USE THE ALBANIAN LANGUAGE AS AN OFFICIAL LANGUAGE IN MACEDONIA: THE NEW DRAFT LAW, ITS CONTENT, ADVANCEMENT AND COMPARISON, 6 th UBT Annual International Conference Durrës, Albania 27-29 October 2017;
- Udhëzimet e Lubjanës për Integrimin e Shoqërive Diverse & Shënime shpjeguese, Nëntor 2012;
- Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve, 1992;
- Raporti shpjegues i Kartës Evropiane për Gjuhët Regjionale ose të Pakicave;